




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 47-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 23 nëntor 2025 (java e 47-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 9,768 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 2,267 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 16 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 47-të (17.11.2025-23.11.2025) janë raportuar 1,429 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 388 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 6 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 304 raste ILI dhe 15 raste ARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 47-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rritje prej 3.17%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Pejës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atkuar është 0-4 vjeç (1,624 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (273 raste), 15-64 vjeç (257 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (113 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri me 26 nëntor 2025, janë testuar gjithsej 1,249 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 627 (50.2%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 622 (49.79%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 19 raste (3.0%). Nga 622 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 24 raste me Influcencë A (pozitiviteti 3.85 %). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (7 raste), Mitrovicë (7 raste), Skenderaj (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Viti dhe Vushtrri dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (12 raste), 5-14 vjeç (8 raste), 15-34 vjeç (3 raste) dhe 35-50 vjeç (1 rast). Gjatë javës së katërdhjetë e shtatë (17.11.2025-23.11.2025), nga laboratoret private janë raportuar gjithsej 50 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 63 mostra me RSV, 136 mostra me Human Rhinovirus, 78 mostra me Human Adenovirus, 18 mostra me Parainfluenza Virus dhe 5 mostra me Metapneumovirus (Graf.5).


Rastet pozitive në RSV (10.13%), janë nga komuna e Prishtinës (28 raste), Fushë Kosovë (12 raste), Ferizaj (3 raste), Lipjan (3 raste), Gjilan (2 raste), Obiliq (2 raste), Podujevë (2 raste), Prizren (2 raste), Rahovec (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Istog, Kaçanik, Klinë, Malishevë, Mitrovicë, Viti dhe Vushtrri. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (55 raste), 5-14 (4 raste), 15-34 (2 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (1 rast) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 është konfirmuar një rast apo 4%, me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 2 raste apo 8% dhe me Influcencë A të pa subtipizuar janë konfirmuar 21 raste apo 88%.(Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 18 nëntor janë administruar gjithsej 50,042 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 34,000 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 14,489 me sëmundje kronike, 1,091 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 24 fëmijë (0-5 vjeç), 192 zyrtarë policorë dhe 25 mësimdhënës.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatrisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 40 raste me ARI, 14 raste me ILI, 6 raste SARI dhe 1 rast me Influcë A.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 47/2025 NË EVROPË**

Në javën 47 të sezonit 2025/26, mbikeqyrja epidemiologjike në Rajonin Evropian tregon një rritje të qartë të aktivitetit të viruseve respiratore, me fillimin e epidemisë sezonale të gripit pasi pozitiviteti në kujdesin parësor kaloi pragun 10%. Nivelet e ILI/ARI janë mbi nivelin bazë në gjashtë vende, me aktivitet më të lartë kryesisht në pjesën perëndimore të rajonit. Hospitalizimet dhe pozitiviteti i gripit nga mbikeqyrja spitalore janë rritur, sidomos te moshat ≥ 65 vjeç, ndërsa shumica e mostrave pozitive janë të tipit A, kryesisht A(H3). SARS-CoV-2 paraqet ulje të vazhdueshme rajonale, edhe pse ngarkesa mbetet e lartë në disa vende. Ndërkohë, RSV po rritet, sidomos tek fëmijët nën 5 vjeç. Pozitiviteti në qendrat sentinel për gripin arriti në 17%, me variabilitet të madh ndërmjet vendeve, ndërsa SARS-CoV-2 ra në 5% dhe RSV mbeti në 2%. Mostrat pozitive nga qendrat sentinel të gripit vijnë të dominohen nga virusi A (99%), me nënpjesëmarrje të A(H3) si nënvarianti kryesor. Mbikeqyrja e SARI tregon rritje të pozitivitetit për grip (12%), me profil virologjik të ngjashëm me atë të komunitetit—përsëri dominues A(H3). Hospitalizimet për grip në raportimet jashtë qendrave sentinel mbeten përgjithësisht të qëndrueshme, me COVID-19 në nivele të ulëta vdekshmërie dhe mortaliteti të përgjithshëm brenda pritshmërive sezonale sipas EuroMOMO. Karakterizimi virologjik tregon se aktiviteti i gripit që nga java 40 është dominuar nga A(H3), ndërsa A(H1)pdm09 përbën pjesën tjetër të konsiderueshme. Rekomandimet e OBSH-së për vaksinën trivalente të sezonit 2025/26 përfshijnë shtame përfaqësuese të linjave A(H1N1)pdm09, A(H3N2) dhe B/Victoria. Ky profil i javës 47 tregon hyrjen në aktivitet intensiv sezonal të gripit, rritje të RSV dhe një situatë të qëndrueshme por të mbikëqyrur për SARS-CoV-2, duke theksuar rëndësinë e mbikeqyrjes së vazhdueshme virologjike dhe klinike.

Burimi: <https://erviss.org/>